

UDHËZIM

Nr. 23, datë 5.3.2009

PËR FORMATIN E FORMULARIT TË DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT MBI LOJËRAT E FATIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 64 pika 4 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Miratimin e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit, sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Ky formular do të shtypet në dy (2) kopje, shtypja do të bëhet me letër vetëkopjuese. Dimensioni i formatit është: A4, me udhëzues traktor. Formulari do të prodhohet në faqe të formatit "Letër" si formularët e tjerë "traktor". Shënimet sqaruese për plotësimin e këtij formulari do të jenë vetëm në pjesën e prapme të kopjes së dytë.
3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode